



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



5.

Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Pranuar - Primesha Në/Dana: 08.02.2012			
Nr./I organit Org.broj	Numri/Broj	Shtoiçë Prilog	Vlera Vrednost
01-013/130			

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenin 12.2 shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 2008/28 dhe nenit 36.2. shkronja a) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01- 013/491 të datës 21.04.2011 Kërkesës së MAPL-së për rishikimin dhe harmonizimin e Statutit të Komunës së Vitisë, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 06 shkurt 2012 aprovon këtë:

## V E N D I M

### PËR NDRYSHIMIN DHE HARMONIZIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS SË VITISË

#### Neni 1.

Me këtë vendim aprovet ndryshimi dhe harmonizimi i dispozitat e Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011. dhe atë: neni 13.1 dhe 13.2, neni 14.3, neni 14.4, neni 16.5, neni 22.6 dhe neni 46.1.

#### Neni 2.

#### **Marrëdhëniet me fshatrat – shtrirja administrative në vendbanime**

Neni 13.1 dhe 13.2 riformulohen si vijon:

13.1. Komuna e Vitisë ka të drejtë të lidhë marrëveshje me fshatrat, lagjet apo vendbanimet brenda territorit të saj, për tu afruar më afër shërbime qytetarëve të Komunës së Vitisë në pajtim me nenin 34 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr03/L-040.

13.2. Komuna e Vitisë mundë të bëjë marrëveshje me fshatra , vendbanime dhe lagjet brenda territorit të Komunës për ti përmbushur të gjitha nevojat për të gjithë qytetaret e Komunës së Vitisë në pajtim me Ligjin për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040 dhe Udhëzimit Administrativ 2008/08 për Marrëveshje bashkëpunimi të Komunës me fshatra vendbanime dhe lagje.

#### Neni 3.

#### **Bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërkombëtar i komunës**

Neni 14.3 riformulohet si vijon:

14.3. Komuna e Vitisë ka të drejtë të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me organet e huaja të vetëqeverisjes lokale në të gjitha fushat e kompetencave vetanake komunale dhe kompetencave të zgjeruara me përjashtim të atyre në paragrafin 2 të nenit 40 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale.

Pas paragrafit 14.3 shtohet paragrafi i ri 14.4 si vijon:

14.4. Komuna do ta njoftoj ministrinë përgjegjëse për qeverisje lokale për çdo synim të bashkëpunimit ndërkufitar. Njoftimi përfshin draft marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe partnerëve të propozuar.

Paragrafi 4 i nenit 14 të Statutit në fuqi rinumërohet si paragrafi 14.5.

Neni 4.

Neni 16.5 riformulohet si vijon:

16.5. Vendi, koha dhe data e mbajtjes së tubimeve publike shpallet dhe publikohet në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës dhe në vendet frekuentuese në qytet në lagjet urbane dhe në fshatra, në ueb-faqen e Komunës si dhe në mediumet elektronike lokale, së paku 14 ditë para mbajtjes së tubimit publik. Shpallen publike e bënë Zyra për marrëdhënie me publikun e cila kujdeset për organizimin e tubimeve publike.

Neni 5.

Neni 22.6 riformulohet si vijon:

Ankesat dhe parashtrirat e qytetarëve për qasje në dokumente publike do të shqyrtohen në pajtim me Ligjin për qasjen në dokumente publike nr. 03/L-215 dhe akteve nënligjore të organeve qendrore.

Neni 6.

Neni 46.1 riformulohet si vijon:

Komitetet Konsultative themelohen nga Kuvendi i Komunës së Vitisë pas propozimit të marrë nga Kryetari i komunës së Vitisë, nga Komitetet e përhershme në komunë dhe nga grupet e qytetarëve.

Neni 7.

Autorizohet Komisioni për ndryshimin dhe harmonizimin e Statutit dhe Zyra Ligjore që ndryshimet dhe harmonizimet e aprovuara nga Kuvendi i Komunës së Vitisë ti inkorporoj në Statutin e Komunës së Vitisë numër 01-013/491 të datës 21.04.2011.

Neni 8.

Vendimi për ndryshimin dhe harmonizimin e Statutit të Komunës së Vitisë hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Viti, 06.02.2012

KRYESUESI I KUVENDIT

Skenderbe Hebibi

